



Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-222 Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, nxjerr:

VENDIM SHPJEGUES PUBLIK NR. 01/2015 PËR METODAT INDIREKTE TË KONTROLLIT

QËLLIMI

Qëllimi i këtij Vendimi Shpjegues Publik është të sqaroj të drejtën, mënyrën dhe rrethanat në të cilat bazohet Administrata Tatimore e Kosovës me rastin e aplikimit të Metodave Indirekte të Kontrollit me qëllim të vlerësimit objektiv të detyrimit tatimor të tatimpaguesit.

Misioni i ATK-së është zhvillimi në nivelin më të lartë të përmbushjes vullnetare në përputhje me ligjet dhe rregulloret që janë në fuqi e gjithashtu edhe dhënia e shërbimeve profesionale, transparente dhe efektive për tatimpaguesin.

Mirëpo, Administrata Tatimore ka obligim dhe detyrë të vendosur me ligj që të sigurojë zbatim të njëtrajtshëm të dispozitave ligjore për të gjithë tatimpaguesit, në mënyrë të njëjtë për situata të njëjta.

PËRKUFIZIM

Metodat indirekte të kontrollit (MIK) përfshijnë përcaktimin e detyrimeve tatimore përmes një analize të çështjeve financiare të tatimpaguesit duke përdorur informacione të nxjerra nga një varg burimesh, përtej deklaratave tatimore, librave formale dhe të dhënave të tatimpaguesit .

Vlerësimet shpesh bazohen në provat e varura nga rrethanat që tregojnë një vlerësim të arsyeshëm të detyrimeve korrekte të tatimpaguesit. Këto informata mund të merren nga analiza e ndryshimeve në pasurinë neto të tatimpaguesit, dokumentacioni i shpenzimeve me para në dorë të tatimpaguesit ose depozitave bankare, burimet e fondeve të tatimpaguesit dhe aplikimit për fonde, etj.

Metodat Indirekte i ofrojnë administratës tatimore një mjet shumë të dobishëm për të përcaktuar saktësinë e deklaratave të tatimpaguesit prandaj, si të tilla, inkurajojnë përmbushjen e detyrimeve sepse përcaktojnë detyrimet e tatimpaguesit kur të dhënat e raportuara nga ana e tij nuk pasqyrojnë në mënyrë adekuate çështjet financiare.

Përdorimi i metodave indirekte shërben për të vërtetuar/kontrolluar të dhënat (shifrat) e deklaruara. Për më tepër, shërbejnë për të vërtetuar/kontrolluar nëse janë deklaruar të hyra të ulëta (nën-deklarim i të hyrave) gjegjësisht shpenzime të larta (mbivlerësim i shpenzimeve).

BAZA LIGJORE

Ligji Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat në Nenin 17 (Deklaratat tatimore), paragrafin 1, thekson:

Çdo person që i nënshtrohet çdo lloji tatimi sipas legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë do të dorëzojë në ATK ose tek agjenti i saj një deklaratë të plotësuar sipas kërkesave të këtij ligji.

Ndërsa, në paragrafin 2, thuhet:

Kur rrethanat tregojnë se një person duhet të dorëzojë një deklaratë tatimore, por nuk e ka bërë atë, ATK do të ketë autorizim të kërkojë që personi i tillë të dorëzojë një deklaratë tatimore. Kur kërkesa e tillë nuk është plotësuar, ATK mundet të ushtrojë autorizimin e paraparë në nenin 19 të këtij Ligji.

Neni 19-Vlerësimi i Drejtorit të Përgjithshëm për Tatimin, i jep të drejtë ATK-së që të bëjë vlerësimin e detyrimit tatimor të tatimpaguesit. Citojmë paragrafët 1, 2 dhe 3:

1. *Aty ku Drejtori i Përgjithshëm beson se informatat e siguruara nga një person në deklaratën tatimore nuk paraqesin në mënyrë të saktë detyrimin e tij tatimor, ose kur tatimpaguesi nuk ka dorëzuar deklaratën e kërkuar me këtë ligj, Drejtori i Përgjithshëm mund të bëjë një vlerësim të detyrimit të tij tatimor, përfshirë, por duke mos u kufizuar në, vlerësimet që rezultojnë nga përdorimi i faturave apo transaksioneve false. Përveç për rastet që përfshijnë vepra penale në fushën e tatimeve apo kur shuma e obligimit tatimor mund të përcaktohet deri në siguri të arsyeshme, vlerësimet sipas këtij paragrafi do të bëhen pas fillimit të procedurave të kontrollit sikurse janë përshkruar në nenin 14 të këtij ligji, nëse procedurat e tilla kërkojnë. Kufizimi i vënë me këtë paragraf nuk do të aplikohet në dispozitat e nenit 21 të këtij ligji (Vlerësimet në rast rreziku).*
2. *Vlerësimi i Drejtorit të Përgjithshëm do të bëhet sipas gjykimit të tij ose saj më të mirë dhe do të bazohet në të gjitha provat që ai ose ajo ka në dispozicion, përfshirë:*
 - *librat, regjistrimet, kuponët, faturat, ose informatat tjera përkatëse të tatimpaguesit;*
 - *librat, regjistrimet, kuponët, faturat, ose informatat tjera përkatëse të personave të tretë;*
 - *informatat nga personat të cilët mund të verifikojnë saktësinë e deklaratave, librave dhe regjistrimeve të tatimpaguesit,*
 - *informata të tjera objektive rreth të ardhurave ose shitblerjeve të tatimpaguesit lidhur me detyrimin e tij.*
 - *informatat e siguruara gjatë vizitave tek tatimpaguesit sikurse është paraparë në paragrafin 1 të nenit 14 të këtij ligji;*
 - *aplikimin e këtij Ligji dhe/apo ligjet e aplikueshme të tatimeve në të ardhura apo TVSh në Kosovë.*
3. *Në qoftë se librat dhe regjistrimet e tatimpaguesit kanë humbur apo janë shkatërruar ose ekzistojnë rrethana tjera që bëjnë të pamundur përcaktimin e detyrimit tatimor, Drejtori i Përgjithshëm do të bëjë një vlerësim bazuar në një parashikim. Parashikimi duhet të bazohet*

në mjetet, të ardhurat qarkulluese, shpenzimet e prodhimit, shpenzimet krahasuese, dhe metodat tjera direkte dhe indirekte që lidhen me llogaritjen e detyrimit tatimor.

Aplikimi i Metodave Indirekte të Kontrollit (MIK) është rregulluar edhe përmes Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2010 respektivisht nenit 30 të tij:

1. Sikurse është parashikuar në paragrafin 3, të Nenit 19 të Ligjit, kur ekzistojnë rrethanat që bëjnë të vështirë përcaktimin e një detyrimi tatimor për shkak të mungesës së regjistrimeve, regjistrimeve false, apo arsye të ngjashme, ATK mund të përdorë metodat indirekte, të cilat janë të përshtatshme për llogaritjen e detyrimit tatimor të tatimpaguesit.

Këto metoda, mund të përdoren në raste kur nuk janë dorëzuar deklaratat, si dhe në rastet në të cilat ka dyshim se nuk ka saktësi të detyrimit tatimor të deklaruar.

2. Para përdorimit të metodës indirekte, ATK, duhet të përcaktojë detyrimin tatimor të saktë duke përdorur metoda direkte të kontrollimit të librave dhe regjistrimeve të tatimpaguesit.

3. Metodatat indirekte të verifikimit dhe ri-llogaritjes së fitimeve, janë vegla themelore për të sjellë kontrollin në një përfundim të saktë, në mungesë të librave dhe regjistrimeve të duhura. Përdoren disa lloje të metodave indirekte. Disa shembuj të tyre janë:

- *Metoda e Burimit dhe Aplikimit të Fondeve,*
- *Metoda e Depozitave Bankare dhe Shpenzimeve të Kesh-it,*
- *Metoda e Marzhës,*
- *Metoda e Njesisë dhe Vëllimit,*
- *Metoda e Vlerës Neto.*

Në praktikën e administratave tatimore përdoren edhe metoda të tjera indirekte si p.sh.:

- *Ri-kalkulimi,*
- *Krahasimi i brendshëm i ndërmarrjeve,*
- *Krahasimi i jashtëm i ndërmarrjeve etj.*

Sqarim për termin “mungesë” e librave gjegjësisht regjistrimeve të duhura

Në paragrafin 3 të nenit 30 të Udhëzimit Administrativ të cituar më sipër, togfjalëshi “në mungesë të librave dhe regjistrimeve të duhura”, për tu kuptuar dhe trajtuar drejtë, kërkon shpjegim të veçantë.

Është e pashmangshme që ky term duhet kuptuar duke pasur parasysh tekstin e ligjit. Kjo nënkupton që metodat indirekte të vlerësimit mund të përdoren nëse librat dhe regjistrimet nuk janë bërë mënyrë të duhur/rregullt. Kjo dispozitë nuk nënkupton që metodat indirekte të vlerësimit mund të përdoren vetëm nëse nuk ka libra gjegjësisht regjistrime. Përkundrazi, MIK duhet aplikuar në rastet kur librat dhe regjistrimet janë të mangëta dhe nuk janë të besueshme.

Kërkesat legjislative për përdorimin e Metodave Indirekte

Nëse tatimpaguesi dështon të përmbush kërkesat ligjore që janë të lidhura me detyrimin e tij tatimor, Administrata Tatimore duhet të përzgjedh metodën më të përshtatshme për të përcaktuar

sa më objektivisht detyrimin, qoftë duke ekzaminuar regjistrimet e ofruara apo, në mungesë të tyre, kur ato vlerësohen të mangëta ose jo të besueshme, duke përdorur metodat indirekte të vlerësimit.

Ato nuk kufizohen vetëm në situatat ku të dhënat duken jo të besueshme. MIK mund të përdorën për të treguar pasaktësitë e deklarimeve edhe në rastet kur shënimet janë të prezantuara “ si pasqyra korrekte”.

Përdorimi i MIK për aspekte të vlerësimit tatimor nuk duhet të kuptohet si metodë e kundërt në kuptimin tradicional të dokumentimit të kontrolleve. Kjo metodë përdor thjesht dëshmi dhe dokumente të tjera për të vërtetuar bazën tatimore (të ardhurat e nën-deklaruara).

Metoda indirekte është njësoj efektive në zbulimin e të ardhurave të pa-raportuara (nën-deklaruara) ose shitjeve nga aktivitetet ligjore dhe joligjore. Përmes kësaj metode mund të identifikohen lloje të ndryshme të të ardhurave dhe shpenzimeve të cilat bizneset nuk i raportojnë, qoftë për qëllime tatimore apo edhe për qëllime të tjera.

Shpesh herë bizneset reduktojnë shpenzimet e tyre në mënyrë që përqindjet e bruto fitimit të tyre të korrespondojnë me ato të industrisë!

Kur duhet përdorur një metodë indirekte?

Ndryshe nga mbështetja në mënyrë ekskluzive në të dhënat e regjistruara të tatimpaguesit, për të vërtetuar detyrimin tatimor përmes metodave indirekte kërkohet mbështetja në një sërë dokumentesh të tjera, pjesa më e madhe e të cilave është krijuar për qëllime të tjera.

Analiza e saktë , prezantimi i këtyre dokumenteve të tjera dhe dëshmime rrethanore të të ardhurave, mund të tregojnë detyrimin tatimor të pa-raportuar (nën-dekluar), të tatimpaguesit.

Çdo vlerësim nga ana e zyrtarit tatimor duhet të bazohet në fakte.

Metodat indirekte të vlerësimit mund të përdoren nëse:

- *librat dhe regjistrat e tatimpaguesit janë të pamjaftueshme ose nuk i pasqyrojnë plotësisht dhe në mënyrë të saktë (të plotë) çështjet financiare të tatimpaguesit;*
- *Inspektori dyshon në nën-deklarimin e të ardhurave.*

Treguesit e nevojës për përdorimin e një apo më shumë metodave indirekte përfshijnë:

- *Pasuritë e pasqaruara ose të ardhurat e deklaruara që nuk janë në përputhje me mënyrën e jetesës së tatimpaguesit ose me standardin e tij të jetesës;*
- *Të ardhurat e deklaruara nuk janë në përputhje me veprimtarinë e biznesit të tatimpaguesit;*
- *Dështimin për të mbajtur shënimet e duhura ose dosjen e deklaratave;*
- *Deklaratat nga tatimpaguesit që pasqyrojnë humbjet e vazhdueshme të deklaruara për një periudhë të gjatë;*
- *Bizneset që kryesisht operojnë me para të gatshme "biznes që operojnë me cash " (shumica e transaksioneve / operacioneve janë me para të gatshme);*

- *Mbajtja e të dhënave është e varfër, kontrollet e brendshme janë të dobët dhe dokumentet nuk janë të kompletuara, etj.*

Të gjitha këto informata mund të merren përmes një interviste të përgatitur mirë me tatimpaguesin, informatave nga palët e treta si dhe mbledhjes së informatave gjatë kontaktit të parë. Të gjitha dëshmitë duhet të jenë të dokumentuara. P.sh. pushimet familjare me një kosto të lartë duhet të sigurohen nga agjencia që ka bërë organizimin e pushimit ose , blerja e tokës duhet të dëshmohet nga drejtoria për kadastër dhe gjeodezi, intervista me shitësin e tokës apo ndërmjetësin etj.

Zgjedhja e metodës indirekte që duhet të përdoret kur bëhen përpjekje për të përcaktuar të ardhurat e sakta të tatimpaguesit do të varet nga natyra e biznesit , faktorët e veçantë dhe rrethanat e rastit. Disponueshmëria e të dhënave të duhura është shumë e rëndësishme.

Data: 15/05/2015

Drejtori i Përgjithshëm, ATK

(Behxhet Haliti)

